

RREGULLORE MBI**PERDORIMIN E LOGO-s DHE TE CERTIFIKATES****KODI: FISA-RR-112****TABELA E RISHIKIMEVE**

Nr.	Data e lëshimit	Përshkrimi	Hartoi Kons/DT	Kontrollo i Men.cil	Miratoi Admin
1	15.09.2023	Botimi i parë	M.Cukall a	Dhurata Lohja	Migena Buzra

PASQYRË E PËRMBAJTJES

1. Qëllimi
2. Fusha e zbatimit
3. Referencat
4. Përkufizime dhe shkurtime
5. Përgjegjësi
6. Përshkrimi
 - 6.1. Logo e FISA-s
 - 6.2. Marka e konformitetit e FISA-s
 - 6.3. Përdorimet e lejuara të Markës së Konformitetit të Fisa-s.
 - 6.4. Përdorime të ndaluara të markës dhe referencave ndaj FISA-s
 - 6.5. Përdorimi i markës FISA të ndërthurur me markën e DPA.
 - 6.6. Detyrimet në përdorimin e markës FISA
 - 6.7. Detyrimet në përdorimin e markës FISA/DPA
 - 6.8. Përdorimi i certificates referuar certifikimit dhe statusit të tij
 - 6.9. Kontrolli mbi përdorimin korrekt të markës
 - 6.10. Sanksionet

1. QËLLIMI

Kjo rregullore përshkruan politikën e FISA shpk dhe formalizon rregullat për Organizmin të cilit i është lëshuar certifikata, mbi menyrën e përdorimit të markës së konformitetit të FISA-s, simbolit të certifikimit, mbrojtjen e simboleve të certifikimit nga keqpërdorimi, rregullon përdorimin e kombinuar të markës së FISA së bashku me simbolet e DPA. Ky dokument përcakton mënyrën e kontrollit dhe verifikimit të përdorimit të simbolit dhe referencave ndaj certifikimit nga organizatat e certifikuara.

Rregullorja aktuale është pjesë perberese e Rregullores për Certifikimin e Sistemeve të Menaxhimit. Përshkrimet dhe kërkesat e kësaj rregullore paraqesin detyrimet kontraktuale dhe aktive nga lëshimi i certifikates.

2. FUSHA E ZBATIMIT

Kjo rregullore zbatohet nga stafi dhe auditorët e FISA për të verifikuar mënyrën e përdorimit të markës së konformitetit të certifikimit nga shoqëritë kliente.

Rregullorja është e detyrueshme për t'u zbatuar nga organizatat, të cilat janë të certifikuara dhe përdorin simbolin ose referencën ndaj certifikimit. Kjo rregullore zbatohet edhe për kontrollin e përdorimit të markës së DPA.

3. REFERENCAT

ISO/IEC 17021-1:2015	<i>Vlerësimi i Konformitetit- Kërkesat për trupat që kryejnë auditimin dhe certifikimin e sistemeve të menaxhimit</i>
ISO/IEC 17030:2021	Vlerësimi i konformitetit — Kërkesat e përgjithshme për markën e konformitetit nga palët e treta
DA-PO-005	Politika për përdorimin e logos, simbolit të akreditimit dhe referencës në akreditim
FISA -MC-01	Manuali i Cilësisë
FISA-RR-115	Rregullorja për certifikimin e Sistemit të Menaxhimit.

4. PËRKUFIZIME DHE SHKURTIME

4.1 Në këtë dokument nuk ka ndonjë përkufizim të veçantë. Përkufizimet kryesore sipas standardit ISO 17000:2004 “Vlerësimi i konformitetit – Fjalor dhe Parimet e përgjithshme” dhe ISO 17021:2015 *Vlerësimi i Konformitetit- Kërkesat për trupat që kryejnë auditimin dhe certifikimin e sistemeve të menaxhimit*” dhe ISO 17030:2021 Vlerësimi i konformitetit — Kërkesat e përgjithshme për markën e konformitetit nga palët e treta

Markë e konformitetit të palës së tretë: Markë e mbrojtur e lëshuar nga një organ që kryen vlerësimin e konformitetit ndaj një pale të tretë, që tregon se një objekt i vlerësimit të konformitetit përmbush kërkesat e specifikuara të zbatueshme.

Pronar i një marke konformiteti të palës së tretë: Person ose organizatë që ka të drejta ligjore për një markë konformiteti të palës së tretë

Adresa: Rruga Abdyl Frasheri, Nr 4/9+1, Tirana Albania. tel/fax:

E-mail

www.fisa.pro

Lëshuesi i një marke konformiteti të palës së tretë:

Organ që jep të drejtën për të përdorur një markë konformiteti të palës së tretë. Lëshuesi mund të mos jetë pronar i markës së konformitetit të palës së tretë dhe mund të autorizohet të nënlicencojë organe të tjera.

Organizatë: Ndërmarrjet që kërkojnë certifikim për Sistemin e vet të menaxhimit.

4.2 Shkurtime të përdorura:

FISA: Shoqëria FISA shpk

SM: Sistemi i Menaxhimit

QMS: Sistemi i menaxhimit të cilësisë

ISMS: Sistemi i menaxhimit të sigurisë së informacionit

ITMS: Sistemi i menaxhimit të shërbimeve të teknologjisë së informacionit

5. PËRGJEGJËSIA

Përgjegjesi i TCSM është përgjegjës për të siguruar zbatimin e kërkesave të kësaj rregulloreje

Stafi i trupës certifikuese dhe Organizatat e certifikuara janë përgjegjës për zbatimin e rregullave të sanksionuar në këtë rregullore.

6. PERSHKRIMI

6.1 Logo e FISA-S

Logo e FISA është një simbol i regjistruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Markave dhe Patentave. E drejta e kopjimit të kësaj logo i përket Trupit certifikues FISA Shpk. Logo e FISA-s mund të përdoret vetëm nga FISA dhe personeli i saj (i brendshëm dhe i jashtëm). FISA përdor logon e saj në të gjithë dokumentacionin e sistemit të menaxhimit, materialet e promovimit, mediat e komunikimit si dhe në shkresat e lëshuara prej saj. Stafi i FISA-s përdor logon në kartvizitat e tyre ku paraqesin pozicionin e tyre në FISA, dhe vetëm për aktivitetet e kryera për FISA. Auditorët dhe ekspertët e FISA-s mund të përdorin logon vetëm në dokumentet e FISA-s, që ato plotësojnë për vlerësimin e palëve të treta.

Logo përbëhet nga simboli i shoqëruar me emërtimin e shoqërisë "FISA". Poshtë këtij emërtimi shënohet specifikimi në lidhje me objektin e punës së FISA "trup certifikimi sistemesh", si në figurë:



Madhësia dhe ngjyrat origjinale (gri, e zezë, e bardhë dhe e kuqe) janë ato të regjistruara në Drejtorinë e Përgjithshme të Markave dhe Patentave. Madhësia normale e logos është 40x18 mm. Ngjyrat janë:

E bardhë	Bright white
E kuqe	Temperature 4700K

FISA mund të përdorë logon e saj në madhësi më të vogël, në varësi të dokumentit, që mund të shkojë deri në gjysmën e përmasave normale, duke ruajtur raportet gjerësi gjatësi. Është e preferueshme që logo të përdoret në ngjyrat origjinale, por në dokumentet e lëshuara nga FISA logoja mund të përdoret në versionin bardhë e zi.

6.2 Marka e Konformitetit e FISA-s

Marka e konformitetit është simboli, që dëshmon, se objekti i vlerësimit si palë e tretë është konform me kërkesat e specifikuar. Ajo përbëhet nga logo e FISA, e shoqëruar me referencën ndaj sistemit të menaxhimit të certifikuar dhe standardit përkatës, sic tregohet më poshtë.



Marka e Konformitetit është prone ekskluzivisht vetëm e FISA-s. Marka e konformitetit mund të përdoret nga Organizmat e Certifikuar nga FISA për të treguar statusin e tyre të certifikimit.

FISA mban të drejtat ligjore mbi markën e konformitetit, për të cilën ajo vetë jep të drejtën e përdorimit.

Kësisoj, marka e konformitetit e FISA është e mbrojtur ligjërisht kundrejt përdorimit të paautorizuar.

Janë të autorizuar për të përdorur markën e konformitetit të FISA dhe të reklamojnë certifikimin Organizatat që zotërojnë një Certificate të vlefshme të lëshuar nga FISA, por me kusht që të respektojnë dispozitat e kësaj Rregulloreje.

Marka duhet të vendoset dhe riprodhohet në mënyrë korrekte në formë, raporte përmasash dhe versione grafike të paraqitura në këtë rregullore.

Lartësia luhatet 9 mm deri në 18 mm dhe Gjerësia luhatet 20mm deri në 40mm, duke ruajtur raportin lartësi/gjerësi sa 9/20.

Marka mund të riprodhohet në versione monokromatike (bardh e zi ose bardh e gri), duke respektuar raportet e përcaktuara në këtë Rregullore.

Përdorimi i Markave të FISA duhet të jetë gjithnjë i shoqëruar me atë të Organizatës, por nuk duhet ta kalojë atë në përmasa dhe nuk duhet të dalë më shumë në pah.

Marka e certifikimit i dergohet organizatës së certifikuar në menyre elektronike, të njesuar me Certifikatën e Konformitetit. Organizmi i Certifikuar nga FISA mund të perdore marken e certifikimit të saj, të njehsuar në versionin korrespondues të simbolit në certifikatën përkatëse.

6.3 PËRDORIMET E LEJUARA TË MARKËS SË KONFORMITETIT “FISA”

Marka e konformitetit duhet të përdoret nga organizata e certifikuar në përputhje me skemën e certifikimit të kryer dhe nuk duhet, në asnjë mënyrë, të nxisë në treg një informacion mashtrues në respekt të parimeve të qartësisë dhe transparencës.

Adresa: Rruga Abdyl Frasheri, Nr 4/9+1, Tirana Albania. tel/fax:

E-mail

www.fisa.pro

Marka "FISA", sipas rastit, mund të shoqërohet me

përdorimin e markës së DPA në përputhje me përcaktimet në këtë Rregullore dhe mund të përdoret në dokumente tregtare lidhur me veprimtaritë që mbulohen nga sistemi i menaxhimit i certifikuar, duke iu referuar standardit përkatës, si për shembull:

- broshura, materiale të shtypura tregtare, stenda dhe panele panairesh;
- monografi, bilance dhe raporte vjetore;
- letra me kokë, zarfe, fakse, postë elektronike;
- kanceleri;
- material reklamues, reklama institucionale, tabela;
- automjete tregtare, mjete pune dhe transporti;
- veshje pune (këmisha, kominoshe pune e të tjera të ngjashme);
- faqe zyrtare në internet;

Marka e konformitetit nuk duhet të përdoret në asnjë mënyrë për qëllime të ndryshme nga sa janë përcaktuar në marrëveshjen ndërmjet palëve dhe në këtë Rregullore.

Në mënyrë të veçantë, përdorimi i markës mbi produkte dhe mjete instrumentale, duhet të shoqërohet me një shtesë të tipit "Organizatë me sistem menaxhimi të certifikuar" (p.sh. për cilësinë, sigurinë e informacionit, etj.) dhe me normën përkatëse.

Organizata mund të përdorë markën vetëm nëse i referohet:

- veprimtarive që përfshihen në fushëveprimin e certifikimit. Nëse faqja zyrtare në internet ose dokumentet janë të njëjtat për të gjitha veprimtaritë, marka mund të vendoset, por në një mënyrë të tillë që ajo të lidhet vetëm me veprimtaritë që përputhen me qëllimin e certifikimit;
- ndërmarrjes dhe/ose vendndodhjeve të certifikuara. Në rastet kur ndërmarrja ka më shumë se një seli, nga të cilat vetëm disa janë të certifikuara, marka mund të përdoret vetëm për ato të certifikuara. Në mënyrë të ngjashme si rasti më lart, nëse të gjitha selitë përdorin dokumentacion të përbashkët apo të njëjtën faqe zyrtare në internet, marka mund të vendoset vetëm nëse jepet qartësisht lidhja me selitë e certifikuara, për shembull, duke vënë shënimin "Vetëm për veprimtaritë në selinë/të e ...).

Për çdo dokument ose objekt mbartës të Markës FISA, duhet të ruhet një kopje ose një kampion dhe të vihet në dispozicion të FISA, ose t'i dërgohet evidenca përkatëse, nëse kërkohet.

6.4 PËRDORIME TË NDALUARA TË MARKËS DHE REFERENCAVE NDAJ FISA

Përdorimi i Markës dhe referencës ndaj "FISA", e cila sipas rastit mund të shoqërohet me logon e DPA, është i ndaluar në rastet e mëposhtme:

- kur nuk është lidhur ende marrëveshja me FISA SHPK;
- në rastet e tërheqjes nga marrëveshja;
- në rast se mund të çojë në mashtrim ose veprime mashtruese në treg, të marrësit të informacionit ose mund të diskreditojë FISA, si për shembull:
 - o në faqet e internetit ose në dokumentacionin tregtar u bëhet referencë njëkohësisht disa veprimtarive, disa prej të cilave nuk janë të përfshira në marrëveshjen me FISA, dhe veçanërisht veprimtarive që në asnjë mënyrë nuk mund të lidhen me FISA;
 - o është përhapur në mënyrë që të interpretohet si lidhje me natyrë juridike, ekonomike dhe/ose biznesi me Organizatën, së cilës i është dhënë e drejta të përdorë markën;

- o është përhapur në mënyrë që të lërë të kuptohet se organizata që përdor markën mund të lehtësojë klientët në marrjen e shërbimeve të FISA;
 - o është përhapur në mënyrë që të lejë të kuptohet se organizata mund të japë konsulencë mbi shërbimet e dhëna nga FISA;
 - o është përhapur në mënyrë që të krijojë ngatërresa me lloje të tjera certifikimesh (për shembull certifikime të produkteve dhe/ose certifikime të tjera të detyrueshme).
- të vendoset në kartëvizitat e personelit të organizatës, së cilës i është lejuar të përdorë markën e konformitetit.
- të vendoset në:
 - o produkte të realizuara dhe/ose të lëvruara;
 - o ambalazhet kryesore (ambalazh i projektuar për të mbajtur produktin dhe që përben një pjesë të shitjeve të destinuar për konsumatorët apo përdoruesit final), etiketa dhe paketimet: konsiderohet si ambalazh pjesë që mund të hiqet pa shkaktuar dëmtim apo shpërbërje të produktit. Etiketat e llojit ose targat e identifikimit konsiderohen pjesë e produktit;
 - o informacione shoqëruese: të tilla konsiderohen çka është e disponueshme në mënyrë të veçantë ose që mund të veçohet lehtësisht (të tilla janë p.sh. manualët e përdorimit dhe udhëzimet);
 - o çfarëdo lloji dokumentacioni teknik që mund t'i referohet produktit në ndonjë mënyrë, kur Organizata zotëron një sistem menaxhimi të certifikuar (p.sh.: deklarata konformiteti për markën CE, certifikata kolaudimi etj.);
- ☐ Nuk duhet të vendoset LOGO e OÇ në raportet/certifikatat e analizave, provave, kalibrimit apo të inspektimit të lëshuara nga laboratore, qofshin këto të pavarura ose pjesë e një kompanie, me sistem menaxhimi të certifikuar nga OC.

Klientët mund të vendosin deklaratime lidhur me zotërimin e një sistemi menaxhimi vetëm mbi ambalazhimet "dytesore" (ambalazh i projektuar për rigrupimin e ambalazheve kryesore dhe që përdoret vetëm për të mbrojtur këto dhe për të lehtësuar levizjet dhe përdorimin), të një produkti apo në brendi të informacionit shoqërues (sikurse përcaktohet më sipër), me kusht që të respektohen të njëjtat kushte të aplikuar mbi markën e certifikimit të përcaktuar në këto rregullore. Këto deklaratime – të llojit "Organizatë me sistem menaxhimi të certifikuar" (për shembull të cilësisë, mjedisit) – duhet të përfshijnë referenca ndaj:

- identifikimit (p.sh. markën ose emrin) të klientit të certifikuar;
- llojit të sistemit të menaxhimit (p.sh. për cilësinë, mjedisin, sigurinë e informacionit) dhe normën e zbatueshme;
- organizmit certifikues që ka lëshuar certifikatën.

6.5 PËRDORIMI I MARKËS "FISA" TË NDËRTHURUR ME MARKEN E DPA

- Trupi i Certifikimit mund të përdorë Markën e Konformitetit të organizmit akreditues (DPA) vetëm në sektoret e akredituar.
- Përdorimi i Markës së Organizmit Akreditues (DPA) nga Organizatat e Certifikuar lejohet vetëm në shoqërimin e Markës së Organizmit të Akredituar (FISA), dhe në përputhje me rregullat e vendosura nga DPA; gjithashtu permasat e LOGOS së DPA nuk duhet të tejkalojnë ato të LOGOS "FISA".

Adresa: Rruga Abdyl Frasheri, Nr 4/9+1, Tirana Albania. tel/fax:

E-mail

www.fisa.pro

- LOGO e DPA, që mund të perdoret nga klientë të TC të akredituar, perbehet vetem nga pjesa grafike e saj.
- Përveç zgjidhjes grafike, të permendur mësipër (LOGO e DPA e nderthurur me logon “FISA”), lejohet vendosja e tyre ngjitur me logon e shoqerise (poshte, lart, anash), e shoqëruar me shkrimin (dygjuhesh ose njëgjuhesh):

Organizem i Akredituar nga DPA

Body accredited by DPA

6.6 DETYRIME NË VENDOSJEN E MARKËS “FISA”

Organizata duhet të garantojë se:


- Te vendoset menjehere në afersi të LOGOS së TC, poshtë ose anash, formulimi “Certifikim i Sistemit të Menaxhimit (standarti i referuar në certifikatë)” që do të perdoret për të bërë publike mbajtjen e certifikates.
- Dizenjimi, përmasat, ngjyrat, forma, etj të jenë sipas përshkrimeve të dhëna në pikën 6.1 dhe 6.2 të kësaj rregulloreje.
- Te jete percaktuar në mënyrë korrekte, në formulimin e mesipër, standarti ISO, në përputhje me të cilin Sistemin e Menaxhimit të shoqerise është konform, (mund të përshkruhen me shumë standarte për shoqerine që ka në zotërim disa certifikime të sistemit, duke përjashtuar certifikimin e produktit);
- Duhet të ketë deklaruar që është certifikuar sipas standartit referues në certifikatë dhe jo përgjithësisht;
- Zgjidhje të ndryshme nga ato të percaktuara në këtë pikë, janë zgjidhje paraprakisht të autorizuar me shkrim nga OC.

6.7 DETYRIMET NË VENDOSJEN E MARKËS “FISA”/DPA

Shoqëria duhet të garantojë që:

- Do respektohen rreptesisht në të gjitha rastet rregullat e përshkruara më sipër;
- Shoqëria e certifikuar për një lloj certifikimi, e lidhur me një fushë të akredituar, nuk duhet të përdorë kurrë logon e Akreditimit të shëputur nga Marka e Certifikimit të FISA-s së akredituar;
- LOGO e DPA nuk do të perdoret në mënyrë që të nënkuptohet që organizmi i akreditimit të ketë certifikuar apo aprovuar Sistemin e të Menaxhimit të shoqerise,
- Te respektohet nga klientët e certifikuar përdorimi i versionit grafik të Markës së Trupit Certifikues të akredituar

Në vecanti dy LOGO (FISA dhe DPA) duhet të jenë të pozicionuara në afersi të njëra tjetres (horizontalisht ose vertikalisht). Figura e mëposhtme tregon një shembull të vendosjes së tyre.



Adresa: Rruga Abdyl Frasheri, Nr 4/9+1, Tirana Albania. tel/fax:

E-mail

www.fisa.pro

duke mbajtur raportin e dimensioneve te

lartpermendura. Parimisht, per gjera te permasave te medha, dy LOGOT e nderthurura mund te zmadhohen, gjithmone duke mbajtur raportin e dimensioneve te lartpermendura. Përveç paraqitjes grafike si në figure, mund të zbatohet versioni i thjeshtuar me shkrimin “Organizem i akredituar nga DPA”; permasat e shkrimit nuk duhet t'i kaloje (horizontalisht dhe vertikalisht) hapesirat korresponduese te zena nga LOGO e TC.

Ngjyrat baze te perdorura per Marken e Akreditimit (eshte sipas logos se entit te akreditimit)

Nese dokumenti mbi te cilin eshte riprodhuar LOGO nuk stampohet me ngjyra, lejohet qe riprodhimi i logos së DPA nga TC dhe Klientët te tyre te jene bardhë e zi, me dizeno të logos dhe shkrim të DPA qartesisht te lexueshme.

Neqofte se FISA-s mund t'i pezullohet ose hiqet akreditimi, lidhur me nje skeme te caktuar, FISA duhet të lajmerojë në kohen e duhur dhe me shpejtesi klientet e tij me e-mail ose shkresërisht per penalitetin e marrë nga DPA, dhe t'u kërkojë Organizatave të Certifikuar të nderpresin menjehere perdorimin e LOGOS se FISA-s.

6.8 PERDORIMI I CERTIFIKATES, REFERUAR CERTIFIKIMIT DHE GJENDJES SE TIJ.

Organizatat qe kane nje Certificate të Sistemit të Menaxhimit, për një skemë të dhënë të certifikimit, mund:

- Te njoftojne klientet e tyre, furnitorët apo palët e interesuara per pajisjen me certificate dhe kohezgjatjen e saj.
- Te bejne publik dokumentin e certifikates duke mbajtur parasysh menytrat e parashikuara nga rregullorja.
- Ta perdorin certifikaten në respekt të kërkesave të kësaj rregulloreje dhe të marrëveshjeve kontraktuale të lidhur.

Organizatata mund të publikojne lirisht dhe/ose te riprodhojne të plotë certifikaten e tyre, ne përmasa origjinale ose te zvogëluara, duke siguruar që në kopjet e riprodhuara rezultatet të jenë lehtësisht të lexueshme.

Organizata, Sistemi i Manaxhimit i të cilës eshte certifikuar nga FISA, sipas një skeme certifikimi të dhënë, nuk mund te deklaroje ose te beje që të besohet se produktet ose proceset e saj janë vlerësuar, certifikuar ose miratuar nga FISA, vetem ne rastet kur eshte marre certifikimi i produktit sipas skemave te certifikimit te produktit.

Certifikata e leshuar nga FISA eshte e vlefshme per tre vjet, nëse nuk ka rregulla te reja (per shembull rishikimi i Standartit te marre per referim); mirembajtja e saj vjen si rrjedhojë e rezultateve te kenaqshem nga auditimet mbikëqyrse te planifikuara.

Organizata duhet te garantoje qe:

- Te plotesohen kerkesat e FISA-s per t'ju referuar statusit të certifikimit te saj në komunikimet në internet, materiale publiciteti ose dokumenta te tjere;
- Te mos beje, dhe te mos lejoje, deklarime qe mund te krijojne iluzione lidhur me certifikimin e saj;
- Te mos perdore, dhe te mos lejoje perdorimin, e nje dokumenti te certifikimit ose te cdo pjese te tij, ne menyre qe te krijojne iluzione dhe mashtrime;
- Te nderprese perdorimin e te gjithe materialeve publicitare qe i referohen certifikimit, ne rast te pezullimit ose heqjes se certifikimit;
- Te rishikojë të gjithë materialet publicitare kur reduktohet fusha e aplikimit te certifikimit;

- Te mos lejoje qe referimet ndaj certifikimit te sistemit te saj te menaxhimit të lenë të kuptohet qe janë certifikuar produkte/sherbime ose procese;
- Te mos lejoje qe te nenkuptohet qe certifikimi aplikohet ne aktivitete qe jane jashte fushes se aplikimit te certifikimit;
- Te mos perdore certifikimin e saj ne menyre te tille qe te demtoje reputacionin e FISA dhe/ose te procesit te certifikimit dhe te kompromentoje besimin e publikut.

6.9 KONTROLI MBI PËRDORIMIN KORREKT TË MARKËS

FISA kryen kontroll të vazhdueshëm mbi kushtet e përcaktuara të përdorimit të logos së FISA-s dhe references ndaj simbolit të akreditimit, nëpërmjet shqyrtimit të dokumentacionit dhe të faqeve të internetit të organizatave. Në rast se vëren një përdorim jokorrekt të logos së vet, do të ndër marrë të gjitha masat e nevojshme për të ndalur përdorimin dhe për të mbrojtur interesat e veta.

Gjithashtu, verifikimi korrektesës në përdorimin e markës është objekt i të gjitha auditimeve të kryera në Organizatë për mirëmbajtje ose ricertifikim të saj. Kur, gjatë auditimeve, konstatohet përdorim i gabuar i Markës së FISA-s, Lead-auditori e identifikon si Jokonformitetet dhe e klasifikon mbi bazën e rëndësisë dhe kohëzgjatjes së përdorimit të gabuar, në përputhje me procedurën e vlerësimit të jokonformiteteve.

Në rastin e marrjes njoftim për përdorim të gabuar të simbolit, TC organizon një vizitë shtesë për të verifikuar statusin e përdorimit të gabuar, kohëzgjatjen dhe rëndësinë. Kur gjatë vizitave konstatohet përdorim i gabuar i markës së konformitetit, kryevlerësuesi bën klasifikimin e Jokonformitetit. Afati dhe mënyra e trajtimit për zgjidhjen e Jokonformitetit janë përcaktuar në procedurën e vlerësimit të jokonformiteteve.

Në rast se Lead-Auditori konstaton që veprimet korrigjuese të propozuara nga organizata janë të pamjaftueshme për zgjidhjen e jokonformitetit, FISA i rekomandon organizatës marrjen e masave të tjera.

Mos zgjidhja e jo-konformitetit është shkak për pezullimin e certifikimit sipas procedurës së pezullimit, heqjes, reduktimit, zgjerimit të certifikimit. Në rast se edhe pas pezullimit Organizata përdor në mënyrë të gabuar simbolin e certifikimit atëherë FISA fillon procedurën për tërheqjen e certifikimit.

Në rast pezullimi dhe tërheqje të certifikimit, FISA publikon statusin e Organizatës në faqen zyrtare të FISA.

6.10 SANKSIONET

Shkeljet ndaj dispozitave të kësaj Rregulloreje nga ana e organizatave, kur është e zbatueshme, do të penalizohen nga FISA SHPK me marrjen e masave në rend rritës të ashpërisë:

- a) Vërejtje me shkrim me kërkesën për marrjen e masave korrigjuese të nevojshme;
- b) Në rast mungese ose zbatimi të papërshtatshëm të masave korrigjuese dhe këmbëngulje në vazhdimin e shkeljes: pezullim i lejes për përdorimin e logos për një periudhë të përcaktuar sipas rëndësisë së situatës së shkeljes, por gjithsesi deri kur konformiteti me kërkesat e përcaktuara në këtë rregullore të jetë rivendosur;
- c) Në rast të vazhdimësisë së shkeljes dhe/ose përsëritjeve të shkeljeve përtej perudhës së pezullimit, FISA heq të drejtën e përdorimit të logos.

6.10.1 PEZULLIMI I TË DREJTËS SË PËRDORIMIT TË LOGOS

FISA mund të pezullojë të drejtën e përdorimit të markës nëse vëren shkelje nga ana e Organizatës si për shembull:

Adresa: Rruga Abdyl Frasheri, Nr 4/9+1, Tirana Albania. tel/fax:

E-mail

www.fisa.pro

- nuk respektohet kjo Rregullore nga Organizata;
- nuk komunikohen nga Organizata modifikimet e bëra në lidhje me veprimtaritë e zhvilluara nga kjo e fundit mbas lidhjes së marrëveshjes;
- përdorim i pavend i logos.

Pezullimi i lejes së përdorimit të logos komunikohet nga FISA me postë të regjistruar me lajmërim marrjeje.

Në rast pezullimi, Organizata nuk duhet të përdorë në asnjë mënyrë markën dhe referencë të FISA, duke i hequr nga faqja e internetit dhe nga dokumentacioni ku i kishte vendosur.

6.10.2 HEQJA E TË DREJTËS SË PËRDORIMIT TË LOGOS

Heqja e të drejtës për përdorimin e logos vendoset nga FISA në këto raste:

- nëse organizata nuk informon FISA lidhur me procedime aktuale penale dhe/ose administrative, që mund të dëmtojnë imazhin e FISA;
- për pushim të marrëveshjes tregtare;
- për masa të autoriteteve publike dhe/ose gjyqësore;
- mosrespektim i përsëritur i angazhimeve të marra me FISA;
- ndalim i veprimtarive, për të cilat Organizata ka lidhur marrëveshje me FISA;
- falimentim ose likuidim;
- ndryshim i kushteve të vëna nga FISA, në rast se Organizata nuk ka për qëllim të përshtatet;
- nuk arrin të eliminojë në afatet e përcaktuara arsyet që kanë shkatëruar pezullimin.

Vendimi për heqjen e përdorimit komunikohet nga FISA me postë të regjistruar me lajmërim marrjeje ose mjete të tjera të barazvlefshme.

Përtej sa është përcaktuar më lart, FISA rezervon të drejtën për t'u referuar autoriteteve kontrolluese në fushën e veprimtarisë së vet (Autoritet Publik, Organizmi i Akreditimit etj.) për sa u përket abuzimeve dhe përdorimeve jokorrekte të logos së saj.